

RAPORT MONITORIMI
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
JANAR - DHJETOR 2020


Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve arsimore parauniversitare, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, që kontribuon në realizimin e qëllimit të përgjithshëm për shërbim arsimor cilësor.

DPAP-ja ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë e organizuar në:

- ***nivel qendror***, nëpërmjet drejtorisë qendrore-DPAP.
- ***nivel rajonal***, nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar-DRAP.
- njësitë e ofrimit direkt të shërbimeve, të cilat përfshijnë ***zyrat vendore të arsimit parauniversitar ZVAP***.
- ***institucionet arsimore*** të sistemit parauniversitar publik, shkollat.

Misioni i DPAP-së është ofrimi dhe sigurimi i shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes.

Tabela më poshtë paraqet strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar



ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI I FONDEVE BUXHETORE

Monitorimi i Buxhetit Financiar te periudhës Janar-Gusht 2020 për institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, përfaqëson vlerësimin e performancës së fondeve buxhetore nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ato të planifikuar, gjithashtu dhe duke i krahasuar me treguesit e vitit të mëparshëm.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, i detajuar në nivel kategorie shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar kështu sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Drejtoria e Përgjithëshme e Arsimit Parauniversitar ka filluar funksionimin e saj më 20.05.2019, mbështetur në VKM nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrit nr.68, datë 05.04.2019, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar” dhe ka në strukturë e saj:

Punonjës Buxhetorë	01110	Plan 21	Fakt 21
Punonjës me kontratë	01110	Plan 01	Fakt 01

Gjatë vitit 2020 nuk ka qënë e plotësuar për tërë vitin buxhetor me staf për shkak të largimit të disa punonjësve në Zyrë Arsimore Tiranë dhe Durrës. Më tej pas ndryshimit të strukturës është mbyllur pozicioni i specialistit të statistikës dhe është shtuar pozicioni i koordinatorit për rrejtin antikorrupsion (ende i pa plotësuar).

Skema më poshtë paraqet strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR (DPAP)

Titullari : Drejtori

1 Sekretare

**Sektori e Kurrikulës dhe
Zhvillimit Profesional.**

1 përgjegjës SKZHP.

5 specialistë SKZHP.

**Sektori i Inspektimit
dhe Vlerësimit të
Cilësisë.**

1 përgjegjës SIVC.

6 specialistë SIVC.

**Sektori i Burimeve Njerëzore,
Shërbimeve dhe Statistikës.**

1 përgjegjës SBNJSHS.

1 jurist

1Specialiste e Financës,

1 Specialiste e B. Njerëzore,


**1 Specialite e Infraskturës, 1
Specialiste Statistike.**

Për vitin 2020 DPAP ka menaxhuar fondet buxhetore të Pagave dhe Sigurime Shoqërore dhe Shpenzime Operative DPAP vetëm në një program buxhetor :

1. Planifikim Menaxhim.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.88/2019, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, janë çelur fondet nga MASR në institucionin tonë DPAP për vitin 2020 dhe kemi këtë realizim të fondeve buxhetore.

GR	PROG	KAP	PROJEKTI	ART	REALIZIM	PLAN	REALIZIM
					VITI 2019	VITI 2020	VITI 2020
11	01110	1	91101AE	600	10,713,338	19,616,000	18,518,554
11	01110	1	91101AE	601	1,763,471	3,740,872	3,052,517
11	01110	1	91101AE	602	2,050,568	1,200,000	1,182,060
11	01110	1	91101AA	602		1,000,000	801,375
11	01110	1	91101AE	606	5,413,200		
11	01110	1	M110746	231	0	165,000	165,000
11	09120	1	M112624	231	0	1,700,000	0
11	09230	1	M112629	231	0	0	0
Totali					19,941,077	27,421,872	23,719,506



Realizimi i shpenzimeve të personelit në mënyrë analitike

	Analiza		(Gr. Tit. Kap.1, Kap.2, Kap.3, Kap.4)				Totali
			Fondet e Buxhetit				
	N/Art	Emërtimi	01110 AE	01110 AA	9120	9230	
		Numri i punonjesve(sipas programeve)					
		Plan	21	0			21
		<i>Fakt</i>	21	0			21
231		Plan	165,000		1,700,000	0	1,865,000
		<i>Fakt</i>	165,000	0			165,000
	2312101	Shp. ndertesa administrative	165,000				165,000
600		Plan	19,616,000	0			19,616,000
		<i>Fakt</i>	18,518,554	0			18,518,554
	6001001	P.Bazë	3,191,091	0			3,191,091
	6001002	Raporte mjeksore p dh	10,060	0			10,060
	6001003	Sh.Vjetërsi	1,230,435	0			1,230,435
	6001005	Sh.Funk.	13,435,477	0			13,435,477
	6001008	shtese page per kualifikim	650,491	0			650,491
	6001099	Shtesa page te tjera	1,000	0			1,000
601		Plan	3,740,872	0			3,740,872
		<i>Fakt</i>	3,052,517	0			3,052,517
	6010100	Sig.shoq	2,736,235	0			2,736,235
	6011100	Sig.shënd.	316,282	0			316,282
602		Plan	1,200,000	1,000,000			2,200,000
		<i>Fakt</i>	1,182,060	801,375			1,983,435
	6020100	Kanceleri	0	99,002			99,002
	6020200	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	0	128,880			128,880
	6020300	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres.	0	53,000			53,000
	6022001	Elektricitet	349,480	42,254			391,734
	6022002	Uje	60,950	11,033			71,983
	6022003	Sherbime telefonike	30,000	0			30,000
	6022004	Posta dhe sherbimi korrier	84,710	58,210			142,920
	6023100	Karburant dhe vaj	336,000				336,000
	6024100	Udhetim i brendshem.	305,552	312,232			617,784
	6025800	Shpenzime per mirembajtjen e paisjeve te zyrave	0	96,764			96,764
	6029008	Shpenzime taksa vendore te paguara nga institucioni	15,368				15,368
		Plan	24,721,872	1,000,000	1,700,000	0	27,421,872
		<i>Fakt</i>	22,918,131	801,375	0	0	23,719,506

1,983,435



- 6020100
- 6020200
- 6020300
- 6022001
- 6022002

2. FONDET E MIRATUARA:

A- Shpenzime personeli

Fondet e miratuara për shpenzime personeli për vitin 2020 përshijnë fondet e miratuara për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit parauniversitar.

➤ Paga sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Llogaria 600 dhe 601

Fondi i miratuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në zërin paga (600) është në shumën 19,616,000 lekë dhe për vitin 2020 janë realizuar 18,518,554 lekë, ose 94,4% të planit të periudhës Janar-Dhjetor 2020.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601) është në shumën 3,740,872 lekë dhe janë realizuar 3,052,517 lekë ose 81,6% të planit të periudhës Janar-Dhjetor 2020

Krahasuar me realizimin e vitit 2019, në vitin 2020 kemi një rritje të shumës së shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore, sepse në vitin 2019, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar ka ushtruar veprimtarinë e saj në një periudhë më të shkurtër kohore, Maj-Dhjetor .

B- Shpenzime Operative

Fondet e miratuara për shpenzime operative për vitin 2020 përshijnë fondet e miratuara për blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve në funksion të veprimtarisë së institucionit.

➤ Shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera. Llogaria 602

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 në zërin mallra e shërbime të tjera (llogaria 602) është në shumën 2,200,000 lekë dhe janë realizuar vetëm 1,983,435 lekë për periudhën Janar- Dhjetor 2020 ose 90,2 % të planit të periudhës vjetore.

Kjo diferencë në mosrealizim të planit për shpenzime operative rezulton pasi nuk janë realizuar shpenzimet për udhëtim e dieta personeli. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19, pjesa më e madhe e takimeve janë kryer online dhe nuk është realizuar 100% plani i inspektimeve dhe monitorimeve të parashikuara për vitin 2020. Shpenzimet për këtë periudhë kryesisht janë fokusuar për mbulimin e shpenzimeve operative si drita, ujë ,telefon, shërbim postar.

Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar e shtrin veprimtarinë e saj në gjithë institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe Zyrtarë Vendore të Arsimit Parauniversitar. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, mirëmbajtje makine, furnizimin me karburant dhe vaj etj është e lartë.

Situata e krijuar nga Covid-19 ka rritur kërkesat për më shumë shpenzime për mbajtjen pastër të ambienteve e zyrave dhe dezinfektimin e tyre.

C- Transferta për buxhetet familjare dhe individët. Llogaria 606

Për vitin 2020 nuk kemi pasur planifikim fondesh për transferta për buxhetet familjare apo individë dhe gjatë vitit nuk ka pasur rialokim fondesh në këtë llogari, duke i qëndruar planit fillestar.

D- Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 231.

Plani i buxhetit për vitin 2020 në investime kapitale , programi 01110 është 165,000 lekë për suprevizim dhe kolaudim të objektit “Rikonstruksion i godinës së ish DAR Qarku Tiranë”. Faturë kjo që duhej likujduar që në vitin 2019 nga ish DAR Qarku Tiranë, por për mungesë fondi është likujduar në periudhën Janar-Gusht 2020. ***Fondi është miratuar pa TVSH. Për të mundësuar xhirimin në llogari të furnitorit , ky fondi është transferuar në kodin e DPAP-së***

Në programin 09120 kemi pasur fond të miratuar në shumën 10,000,000 lekë për krijimin e fondit të bibliotekave të institucioneve arsimore të Arsimit të Mesëm të Ulët , fond i cili pas rishikimit mbeti në shumën 1,700,000 lekë.

Nuk është realizuar procedura e prokurimit për arsye të situatës së krijuar nga COVID 19. Në periudhën Janar- Qershor 2020 për arsye të pezullimit të prokurimeve nga Agjencia e Prokurimeve Publike dhe më pas për arsye të situatës nuk u mbledhën dot në kohë kërkesat e ZVAP-ve për krijimin e bibliotekave në institucionet arsimore të tyre.

Në programin 09230 kishim fond të miratuar në fillim të vitit në shumën 10,000,000 lekë për krijimin e fondit të bibliotekave të institucioneve arsimore të Arsimit të Mesëm të Lartë, fond i cili nuk u realizua nga DPAP për arsye të mosrealizimit të prokurimit me të njëjtin arsyetim si më sipër dhe në fund të vitit pas rishikimit të buxhetit u bë pakësimi për këto në zero lekë.

MBI RAPORTIMIN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË AKUMULUARA DHE KRIJUARA RISHTAZI PËR VITIN 2020.

Në zbatim të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Shtojca 3, detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluar për vitin 2020 janë:

Detyrimet e prapambetura

Skeduli i pagesave të detyrimeve të prapambetura për vitin 2020		DPAP		Shtojca 3/1
				<i>në mijë lekë</i>
Kategoria / Periudha	Pagesa të kryera për periudhën Janar-Mars	Pagesa të kryera për periudhën Prill-Qershor	Pagesa të planifikuara për periudhën Korrik-Shtator	Pagesa të planifikuara për periudhën Tetor-Dhjetor
Detyrime të prapambetura - Shpenzime Kapitale		1,113,334	0	0
Detyrime të prapambetura - Shpenzime Korente				
Detyrime të prapambetura - Vendime Gjyqësore				
Detyrime Totale		1,113,334		

Për sa më sipër në periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë likujduar të gjitha detyrimet e prapambetura, përfshirë këtu:

- Garanci e punimeve të objektit “Rikonstruksion i godinës së ish DAR Qarku Tiranë” në shumën 948,334 lekë.
- Suprevizim dhe Kolaudim të objektit “Rikonstruksion i godinës së ish DAR Qarku Tiranë”, në shumën 165,000 lekë.

Në zbatim të VKM nr 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithëshme të Arsimit Parauniversitar “, Urdhrit nr.68, datë 05.04.2019, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar”, Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë nuk ushtron më veprimtarinë e saj dhe për pasojë të gjitha detyrimet e prapambetura të mbetura palikujduar kaluan për likujdim në Drejtorinë e Përgjithëshme të Arsimit Parauniversitar

FAKTORËT QË KANË NDIKUAR NË REALIZIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2020

1. Udhëzimi nr. 14, datë 24.03.2020 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në gjendje fatkeqësisë natyrore”.
2. Aktin Normativ Nr.6, datë 21.3.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 88/2019, për buxhetin e vitit 2020”.
3. Urdhëri nr. 135, datë 09.03.2020 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ”Për mbylljen e institucioneve Arsimore për parandalimine përhapjes së COVID 19”;
4. Mosreliazimi i shpenzimeve korente artikulli 602, është kryesisht në zërin Udhëtim e Dieta për shkak të mosrealizimit të inspektimeve,monitorimeve, takimeve nga situatë e krijuar nga COVID 19.
5. Mosrealizimi i zhvillimit të procedurave të prokurimit publik për librin artistik në kuadër të masave kundër COVID 2019.

TË DHËNA MBI NUMRIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE PËR VITIN SHKOLLOR 2019-2020 DHE 2020-2021

Për vitin shkollor 2019-2020 janë gjithsej institucionet si më poshtë:

NUMRI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE					VITI SHKOLLOR 2019-2020			
KOPSHTJE GJITHSEJ		TOTALI KOPSHTJE	Shkolla Publike (drejtori me vete)		TOTALI SHKOLLA PUBLIKE	Shkolla Private		TOTALI SHKOLLA PRIVATE
PUBLIKE	PRIVATE		9-vjecare +Mesme te Bashkuara	Gjimnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjecare	Mesme	
1879	242	2121	1109	147	1256	119	112	231

Në arsimin publik janë 199 shkolla te mesme te bashkuara. Në arsimin publik janë edhe 911 shkolla vartëse

NUMRI I INSTITUCIONEVE ARSIMORE					VITI SHKOLLOR 2020-2021			
KOPSHTET		TOTALI KOPSHTJE	Shkolla Publike (drejtori me vete)		TOTALI SHKOLLA PUBLIKE	Shkolla Private		TOTALI SHKOLLA PRIVATE
PUBLIKE	PRIVATE		9-vjecare +Mesme te Bashkuara	Gjimnaze + mesme të orientuara të veçanta		9-vjecare	Mesme	
1844	249	2093	1060	147	1207	115	105	220

Në arsimin publik janë 199 shkolla të mesme të bashkuara. Në arsimin publik janë edhe 934 shkolla vartëse

TË DHËNA PËR MËSIMIN ONLINE (VIDEO, ETJ) NË KUSHTET COVID-19

Pandemia COVID-19 konsiderohet sfidë globale, ku është përfshirë dhe vendi jonë dhe ka ndikuar në çdo aspekt të jetës duke përfshirë edhe arsimin. Edhe në vendin tonë, MASR-ja ndërpreu procesin mësimor më datë 09.03.2020, duke vijuar me zhvillimin e procesit mësimor në dy forma: orë mësimore në Radio Televizionin Shqiptar (RTSh) dhe mësimin online sipas lëndëve dhe klasave nga mësuesit lëndorë. Në vijim të punës për zhvillimin e mësimin në distancë, nga ana e mësuesve ka patur një angazhim maksimal për

zhvillimin e mësim, duke përdorur gjerësisht përgatitjen e materialeve mësimore në formatin video shoqëruar edhe me material të shkruar shpjegues. Një pjesë e videove, kanë gjetur vend duke u publikuar jo vetëm në rrjetet sociale të shkollave por edhe te faqet zyrtare të ZVAP-ve, por edhe në faqen facebook të DPAP-së. DPAP-ja, me ndihmën e grupeve të mësuesve në disa Zyra Arsimore Vendore ka arritur të organizojë punën, për të përgatitur video mësimore të unifikuara për gjithë territorin duke i vendosur në dispozicion të mësuesve. Më poshtë të dhënat për videot e realizuara.

Nr.	DRAP	NUMRI I VIDEOVE TË PUBLIKUARA
1	DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS	112,836
2	DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER	49,201
3	DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË	93,855
4	DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË	32,056
	TOTALI	287,948

TË DHËNA PËR PAJISJEN E NXËNËSVE ME TABLETA, TELEFON

Në ndihmë të nxënësve të cilët nuk kishin akses në mësimdhënien online, ku bëjnë pjesë nxënës të klasave kolektive, nxënës banesat e të cilëve janë prekur nga tërmeti si edhe kategori të tjera në nevojë që nuk kishin akses gjatë muajve të parë të pandemisë në mësimdhënien online janë shpërndarë:

- 4 931 pajisje elektronike dhuratë nga kompania “Vodafone” në muajin Prill 2020;
- 500 pajisje elektronike dhuratë nga kompania “Ecolog International” në muajin Maj 2020;
- 500 pajisje elektronike dhuratë nga “Unicef Albania” në muajin Shtator 2020;
- 10 000 pajisje elektronike dhuratë nga kompania “Vodafone” në muajin Dhjetor 2020.

DPAP-ja ka hartuar planin vjetor për vlerësimin e institucioneve në Arsimin Parauniversitar duke u mbështetur në realizmin e Strategjisë së MASR-së 2014-2020 dhe objektivat e DPAP-së për vitin 2020. Vlerësimi i institucioneve në Arsimin Parauniversitar është realizuar nëpërmjet monitorimit dhe inspektimit.

VEPRIMTARI MONITORUESE, ETJ

Matura shtetërore 2020

Në zbatim të Urdhrit Nr.114, dt.18.05.2020 , të MASR - "Rregullore e posaçme për zhvillimin e Matures Shtetërore 2020 në Republikën e Shqipërisë, për shkak të gjëndjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID -19" dhe të Udhëzimit Nr.28 datë 12.12. 2019 dhe Urdhërit nr.537, datë 08.11.2019 “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, DPAP-ja me përfaqësuesit e saj monitoroi sesionin e parë të zhvillimit të provimeve në Gjuhë shqipe dhe Letërsi, Matematikë, dhe lëndë me zgjedhje në institucionet arsimorë dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar në bashkëpunim me punonjës të MASR, ASCAP, DRAP. Pjesëmarrja e maturantëve në provime ishte rreth 96.5%. Matura shtetërore u zhvillua në kushtet e respektimit të masave anticovid.

Provimet e lirit 2020, provimet kombëtare klasa e V

Për vitin shkollor 2019-2020 për shkak të pandemisë Covid-19 nuk u zhvilluan provimet kombëtare të klasës së 5-të dhe të klasës së 9-të 2020. Nxënësit e klasës së 9-të u vlerësuan bazuar në “Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020” të ASCAP.

Përzgjedhja dhe shpërndarja e teksteve

Në zbatim të Urdhrit nr.106, datë 30.04.2020, "Për porositjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1 dhe 6-12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2020-2021" përzgjedhja e teksteve mësimore për vitin shkollor 2020-2021 do të ishte e njëjtë me përzgjedhjen e teksteve mësimore për vitin shkollor 2019-2020. Për vitin shkollor 2020-2021, skema e subvencionimit të teksteve falas për nxënësit është rritur deri në klasën e 7. Gjithashtu përfitues të teksteve falas janë edhe 17 kategori të tjera në nevojë për klasat 8-12.

DPAP-ja ngriti grupin e punës me specialistë dhe përgjegjes të SKZHP në DRAP-e dhe ZVAP-të të cilat monitoruan procesin e shpërndarjes në përgjithësi i tekstit shkollor, i teksteve në përdorim falas dhe evidentimi i kategorive që përfitojnë falas tekstet shkollore deri në klasën e 12-të. Rreth 250 mijë nxënës janë përfitues të teksteve falas në arsimin parauniversitar.

Shpërndarja e teksteve është realizuar si më poshtë vijon:

DRAP	Nxënës përfutues libra falas klasa I	Nxënës përfutues libra falas klasa II	Nxënës përfutues libra falas klasa III	Nxënës përfutues libra falas klasa IV	Nxënës përfutues libra falas klasa V	Nxënës përfutues libra falas klasa VI	Nxënës përfutues libra falas klasa VII	Nxënës përfutues libra falas klasa VIII	Nxënës përfutues libra falas klasa IX	Nxënës përfutues libra falas klasa X	Nxënës përfutues libra falas klasa XI	Nxënës përfutues libra falas klasa XII
Durrës	13380	13082	13366	13313	13137	13299	13077	2613	8875	1624	1410	1375
Fier	4328	4513	5036	5163	4881	5207	5217	1071	956	594	479	421
Lezhë	3980	3943	4194	4085	4132	3982	4193	2007	1982	1442	1371	1383
Korçë	6023	6014	6231	6347	6221	6246	6244	2667	2734	2098	2057	1882
Gjithsej	28028	27552	28827	28908	28371	28734	28731	8358	14547	5758	5317	5061

Fondi i kërkuar për tekstet shkollorë:

DRAP	FONDI I KËRKUAR ARSIMI FILLOR KLASA I-V	FONDI I KËRKUAR AMU KLASA VI-IX	FONDI I KËRKUAR AMU KLASA X-XII	FONDI I KËRKUAR 9120	FONDI I KËRKUAR 9230
Durrës	191404927	125559010	34944915	322463936	34944915
Fier	52161441	66414208	10229038	124381299	11199076
Lezhë	65431355	55169149	32912905	120600504	32912905
Korçë	90788188	80209419	43270039	170997607	44764216
Gjithsej	399785911	327351786	121356897	738443346	123821112

Menaxhimi i portalit “MËSUES PËR SHQIPËRINË 2020”

DPAP është përgjegjëse për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të mësuesit në një vend të lirë pune në sistemin arsimor parauniversitar. Objektivi i saj është të administrojë portalin "Mësues për Shqipërinë", të cilat për vitin 2020 janë realizuar sipas objektivave specifike si më poshtë:


- Hartimin e listës së kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë të konkurrimit dhe që morën pjesë në testim, bashkë me pikët e përfituara në dosje dhe dërgimin në QSHA.
- Hartimin e listës së kandidatëve që dëshironin të mbartnin pikët e testimit dhe pikët e dosjeve të konvertuara, të portalit “Mësues për Shqipërinë” të një viti më parë dhe dërgimin në QSHA.
- Hartimin e listës së kandidatëve që dëshironin të mbartnin pikët e testimit dhe pikët e dosjeve të konvertuara, të portalit “Mësues për Shqipërinë” të një viti më parë dhe u plotësuan pikët e testimit dhe të dosjeve të kandidatëve që i mbartën nga portali “Mësues për Shqipërinë” i një viti më parë dhe dërgimin në RASH.
- Koordinoi punën e portalit "Mësues për Shqipërinë" me DRAP, ZVAP, RASH dhe QSHA.
- Shqyrtoi ankimmimet e reflektimit të pikëve të dosjes dhe të testimit të kandidatëve në portalin "Mësues për Shqipërinë", në bashkëpunim me DRAP, QSHA dhe RASH.
- Publikoi listat e kandidatëve sipas DRAP-eve të pikëve të fituara në dosje për konkurrim në portalin “Mësues për Shqipërinë” në faqen zyrtare të DPAP-së.
- Publikoi vendet e lira të punës në institucionet arsimore parauniversitare për vitin mësimor 2020-2021 në faqen zyrtare të DPAP-së .
- Monitoroi dhe vijon të monitorojë portalin "Mësues për Shqipërinë" 2020 mbi reflektimin e punësimeve në sistem nga ana e ZVAP-ve. Ky proces do të zgjasë gjatë gjithë vitit deri në procedurat e hapjes së portalit të ri "Mësues për Shqipërinë".

Provimi i shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit, sesioni XV

Në zbatim të shkresës nr. 4332 Prot., të datës 13.08.2020 mbi zhvillimin e provimit të shtetit në profesionin e rregulluar të mësuesit për sesionin XV, DPAP në bashkëpunim me DRAP dhe ZVAP morën masat për regjistrimin e kandidatëve pjesëmarrës, të cilët:


- a) kishin kryer me sukses praktikën profesionale;
- b) kishin rezultuar jo të suksesshëm në sezonet e kaluara;
- c) nuk ishin paraqitur në sezonet e mëparshme;
- d) ishin në marrëdhënie pune dhe kishin përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në edukim.

Shpërndarja e pjesëmarrjes sipas profileve si më poshtë;



III.6 Monitorimi i procesit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit në nivel DRAP/ZVAP

Praktikantët të shpërndarë në 4 DRAP-et: DRAP Durrës 934 praktikantë, DRAP Fier 364 praktikantë, DRAP Lezhë 367 praktikantë, DRAP Korçë 635 praktikantë.



Për shkak të pandemisë Covid-19 DPAP-ja nuk i ka realizuar të gjitha veprimtaritë e hartuara sipas planifikimit në fillim vit.

Kualifikimi i mësuesve 2020

Në provimin e kualifikimit të mësuesve 2020 morën pjesë 2760 mësues nga gjithë Shqipëria. Pas provimit sipas tabelës së mëposhtme rezultoi që:

Nr	VLERËSIMI I KUALIFIKIMIT			VLERËSIMI SIPAS DRAP-ve							
				DURRËS		FIER		KORÇË		LEZHË	
	A-E	Mësues	%	Mësues	%	Mësues	%	Mësues	%	Mësues	%
1	A	37	1.35	24	2.42	6	1.14	5	0.63	2	0.45
2	B	512	18.55	223	22.46	89	16.86	145	18.15	55	12.5
3	C	1230	44.57	452	45.51	236	44.7	354	44.31	188	42.73
4	D	57	2.07	16	1.61	11	2.08	17	2.13	13	2.96
5	E	908	32.89	269	27.09	182	34.47	277	34.66	180	40.9
6	skualifikuar	16	0.57	9	0.91	4	0.75	1	0.12	2	0.45
7	gjithsej	2760		993		528		799		440	

Monitorimi mbi rolin dhe funksionin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore në nivel DRAP/ZVAP

- Hartimi i një database mbi numrin e punonjësve të shërbimit psiko-social në vend sipas shpërndarjes së kryer nga Zvap-të, për mbulimin e institucioneve arsimore me qëllim ofrimin e mbështetjes profesionale për nxënësit dhe mësuesit.
- Mbështetur në VKM-në Nr.243, datë 24. 03. 2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe udhëzimin Nr.111, dt, 26.03.2020 për “Funksionimin e shërbimit psiko - social në kushtet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore” u organizuan të gjithë punonjësit e shërbimit psiko-social për t’ju ardhur në ndihmë nxënësve, mësuesve dhe prindërve.
- Hartimi dhe implementimin i platformës ‘Bashkë kundër sfidave’ në funksion të nxënësve dhe mësuesve gjatë periudhës së pandemisë.

-Riorganizimi i strukturave të punonjësve të Shërbimit Psiko-social dhe koordinimi me katër Drejtoritë Rajonale për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, bazuar në Udhëzimin Nr. 313 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”


Monitorimi i masave të marra për fillimin e vitit shkollor 2020-2021.


Në zbatim të udhëzimit “Mbi kujdesin dhe masat anti COVID-19 në strukturat arsimore parauniversitare për vitin akademik 2020-2021” të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me MASR, DPAP dhe në bashkëpunim me institucionet e varësisë janë realizuar:

- ✓ Analizë e gjendjes së shkollave tona dhe e stafeve të tyre mësimore.
- ✓ Sondazh me 120 mijë mësues, prindër dhe nxënës, nga ku 87% e tyre u shprehën pro kthimit të nxënësve në shkollë. Në javën e tretë të mësimit është zhvilluar nga DPAP-ja një pyetësor tjetër dhe nga 142 mijë prindër, mësues dhe nxënës rreth 90 % preferonin zhvillimin e mësimit sipas skenarit 1, pra në klasë, 7 % skenarin 2, të alternuar midis mësimit në klasë dhe online dhe vetëm 3 % preferoni skenarin 3, mësimin online.
- ✓ U analizuan me shumë kujdes ngarkesat mësimore për çdo shkollë dhe u përcaktuan organikat e nevojshme për vitin mësimor, duke u mbështetur edhe në skenarët e përcaktuar në udhëzues. Pas kësaj analize u transferuan rreth 600 organika në ZVA që kishin nevojë duke u marrë nga zyra të tjera arsimore , ku nuk ishin përdorur si pasojë e rënies së numrit të nxënësve në klasë, për shkak të lëvizjes demografike apo rënies së numrit të lindjeve.
- ✓ U hartua plani i vendosjes së nxënësve në klasa dhe për çdo shkollë është përcaktuar dhe vendosur se cili skenar do të ndiqet, në varësi të kushteve fizike të shkollave dhe numrit të nxënësve.
- ✓ U zhvillua për dy javë, nga data 31 gusht -14 shtator, mësim plotësues për 600 klasa me 4,500 nxënës që nuk kishin patur akses në mësimin online gjatë periudhës mars-maj. Mësimi plotësues përfshinte lëndët bazë, si gjuhë shqipe dhe matematikë, sipas një programi të hartuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar.
- ✓ Mësimi zhvillohet normalisht në të gjitha shkollat e vendit. Janë marrë masa që nxënësit e shkollave të dëmtuara nga tërmeti dhe shkollave të cilat janë në rikonstrukcion të zhvillojnë mësimin në shkollat pritëse. Sot në gjithë vendin: rreth 68% e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar zhvillojnë mësim me një turn, me orë 45 minuta, dhe rreth 32% e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar zhvillojnë mësim me turne të cilat janë të organizuara në 25 deri në 30 minuta çdo orë në varësi të turneve.
- ✓ Është siguruar transport për të gjithë nxënësit dhe mësuesit e 94 shkollave të transferuara. Për herë të parë në skemën e rimbursimit janë futur edhe nxënësit e shkollave të mesme që udhëtojnë në largësi mbi 10 km dhe e zhvillonin mësimin në shkolla që transferohen për shkak të dëmtimit apo rikonsnstruksionit.
- ✓ Rreth 2300 praktikantë janë në ndihmë të mësuesve dhe po japin kontribut në mbulimin e nevojave në rast se mësuesit mungojnë për shkak të karantinimit apo për arsye të tjera.
- ✓ 1,000 mësues me kontratë janë ndarë për secilën ZVA, të cilët në vijim do të jenë në dispozicion për mbulimin e nevojave për zëvendësimin e mësuesve që mungojnë për arsye shëndetësore.

- ✓ Shtator 2020, në rakordim me ZVAP-të dhe MASR është realizuar rishpërndarja e planit të numrit të punonjësve mësimor sipas kërkesave të ZVAP-ve: Arsimi bazë 23, 655 punonjës mësimor; Arsimi mesëm i lartë 6,485 punonjës mësimor.
- ✓ Në mbështetje të urdhrit të Ministrit të MASR nr.313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, në bazë të rakordimit dhe kërkesave të ZVAP-ve është bërë përlogaritja e ndryshimit të numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar .
Në vitin shkollor 2019-2020 kishim 342 punonjës të shërbimit psiko-social.
Në vitin shkollor 2020-2021 janë parashikuar 626 punonjës të shërbimit psiko-social.

➤ Të dhëna për numrin e punonjësve mësimorë në shtet, për vitin shkollor 2019-2020; 2020-2021:





BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE

Gjatë vitit 2020 DPAP-ja ka bashkëpunuar me institucionet duke dhënë sugjerime për:

- Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.
- Draft strategjinë 2021-2026 MASR,
- Udhëzimin Nr.13, datë 22.05.2019 “ Për procedurat e emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimi e portalit “ Mësues për Shqipërinë”, i cili pësoi ndryshime me Udhëzimin nr.20, datë 08.07.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 13, të sipërcituar.
- Udhëzimin nr.57, datë 12.11.2013për “Procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, i cili u ndryshua me Udhëzimin Nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimitdhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”.

- Hartimin e Kartës së performancës së shkollës,
 - Standardet profesionale të inspektorit të institucioneve të arsimit parauniversitar,
 - Urdhërin nr.313, datë 20.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social.
 - Urdhërin 176, datë 01.07.2020 “Për disa ndryshime në urdhërin nr.234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”
 - Draft rregulloren e PKAB.
 - Amzën digjitale.
 - Etj.....
- Nxënës me aftësi ndryshe për çdo shkollë nga 4 DRAP-et dhe numri i mësuesve ndihmës për grupin parashkollor dhe klasat I-XII janë si më poshtë vijon:

NR.	DRAP	Numri i nxënësve me AK në klasa përgatitore & klasat-XII:	Numri i mësuesve ndihmës për vitin shkollor 2020-2021 në IA ; klasa I - V:	Numri i mësuesve ndihmës për vitin shkollor 2020-2021 në IA ; klasa VI - IX:	Numri i mësuesve ndihmës për vitin shkollor 2020-2021 në IA ; klasa X - XII:
1	DURRES	1304	237	150	10
2	FIER	686	245	149	23
3	KORÇË	948	138	127	8
4	LEZHË	511	118	65	4
	TOTALI	3449	738	491	45

Profili i mësuesit të arsimit special është shtuar në listën e profesioneve të rregullura dhe janë licensuar 20 mësuesit e parë në këtë profil, të cilët kanë përparësi në emërimet si mësues ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara në shkolla jo speciale.

Për periudhën Janar - Dhjetor 2020 DPAP zbatoi politikën menaxheriale duke u fokusuar në nevojat e domosdoshme të DPAP dhe duke u përqendruar në përgjegjësitë funksionale të saj, të cilat konsistojnë në:

- 1. Ofrimin e një shërbimi cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.***
- 2. Organizimin e punës për menaxhimin , ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.***
- 3. Koordinimin e administrimit të burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar sipas legjislacionit në fuqi, etj.***

Në periudhën në vazhdim DPAP do të vazhdojë punën për zbatimin me rigorizitet të politikave të institucionit dhe realizimit të objektivave e synimeve kryesore.